

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Sektori i veprave civile, në bazë të nenit 33 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.14/2022), në seancën e mbajtur më 26.12.2022, miratoi:

PLOTËSIM TË MENDIMIT JURIDIK TË DATËS 12.07.2022

Në kumtimin, në rendin e parë, pas fjalës “përmbarrimin”, shtohen fjalët “të plotfuqishme dhe përmbarruese” dhe teksti përfundimtar është:

Për përmbarrimin e vendimeve të plotfuqishme dhe përmbarruese gjyqësore, me të cilat përcaktohen masa të përkohshme si mjete për sigurimin e kërkesës, kompetent është përmbarruesi sipas Ligjit për përmbarrim.

A r s y e t i m

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 12.07.2022 miratoi mendim juridik, sipas të cilit, për përmbarrimin e vendimeve gjyqësore me të cilat janë përcaktuar masa të përkohshme si mjete për sigurimin e kërkesës, kompetent është përmbarruesi dhe të njëjtin e publikoi në ueb faqen e Gjykatës.

Megjithatë, gjatë përgatitjes së mendimit juridik të theksuar si duket është bërë lëshim në kuptim të asaj se për cilat vendime gjyqësore me të cilat janë përcaktuar masa të përkohshme si mjet për sigurimin e kërkesës, kompetent është përmbarruesi edhe krahas faktit të pakontestueshëm në arsyetimin e dhënë të mendimit juridik të miratuar është theksuar dispozita ligjore e nenit 30 të Ligjit për sigurimin e kërkesave, dhe ajo mund të krijojë paqartësi dhe dilema në zbatimin e dispozitave të theksuara.

Në fakt, sipas nenit 30 paragrafi (1) nga Ligji për sigurimin e kërkesave, në rastin kur nuk është ngritur procedurë kontestimore ose ndonjë procedurë tjetër gjyqësore për vendosjen mbi propozimin për sigurimin e masës së përkohshme dhe për zbatimin e masës së përkohshme, me kompetencë vendore është gjykata e cila do të vendoste në procedurën kontestimore. Në paragrafin (2) nga i njëjti nen është shënuar se nëse procedura është ngritur me propozim për sigurimin e masës së përkohshme dhe për zbatimin e asaj mase të përkohshme, me kompetencë vendore është gjykata në të cilën është ngritur procedura.

Sipas nenit 7 nga i njëjti Ligj, në procedurën e sigurimit drejtpërdrejtë zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore dhe dispozitat e Ligjit për përmbarrim, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Sipas nenit 5 paragrafi (1) nga ky Ligj, kundër aktvendimit të miratuar në shkallën e parë për sigurimin e kërkesës, mund të deklarohet ankesë, ndërsa sipas paragrafi (3) ankesa nuk e pezullon përmbarrimin për shkak të sigurimit të kërkesës, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Duke u nisur nga përmbajtja e dispozitave të Ligjit për sigurimin e kërkesave, pa diskutim rezulton se për zbatimin e masës së lejuar të përkohshme me kompetencë vendore

është gjykata që do të vendoste në procedurë kontestimore ose në procedurë tjetër gjyqësore.

Megjithatë, kur vendimi me të cilin lejohet masë e përkohshme bëhet përmbarues sipas nenit 12 paragrafi (1) pika 1 dhe 2 nga Ligji për përmbarim, fiton cilësinë e dokumentit përmbarues dhe paraqet bazë për përmbarim sipas nenit 2 paragrafi (1) nga i njëjti Ligj, përmbarimin e zbaton përmbaruesi kompetent sipas nenit 3 paragrafi (1) nga Ligji i theksuar.

Nga e sipër theksuara, Sektori i veprave civile e plotësoi mendimin e miratuar juridik të datës 12.07.2022.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Sektori i veprave civile